



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Republika e Kosovës

*Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit / Ministarstvo obrazovanja, nauke, tehnologije
i inovacije / Ministry of Education, Science, Technology and Innovation*

Departamenti i Arsimit të Lartë, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit

Departamenti i Arsimit të Lartë, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe Këshilli Shkencor i MASHTI në vazhden e aktiviteteve të tyre, bazuar në dispozitat e Ligjit për Veprimtari Kërkimore-Shkencore nr. 04/L-135, bazuar në planin e veprimit të Programit Kombëtar të Shkencës në lidhje me përkrahjen e studimeve të doktoratës në 500 universitetet më të mira në botë, shpall:

T H I R R J E

Për mbështetje financiare për doktoratë

Ftohen studentët kosovarë që ndjekin studimet e doktoratës në 500 universitetet më të mira në botë sipas listës “Shanghai” të vitit 2023, që të konkurrojnë për përfitimin e mbështetjes financiare për doktoratë në vlerë vjetore prej 8,500 euro. Konkursi është publik dhe vlen për studentët shtetas të Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh promovimin e barazisë gjinore, etnike, fetare dhe racore. Për të aplikuar në këtë thirrje, studentët e interesuar duhet t’i plotësojnë këto kushte:

- Aplikuesi/ja duhet të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Universiteti pritës duhet të jetë në listën e 500 universiteteve më të mira në botë sipas rangimit të listës së Shanghait.
- Përparësi kanë aplikuesit/et që nuk kanë bursë të pjesshme nga ndonjë skemë/institucion brenda apo jashtë vendit;
- Përparësi kanë studentët që studiojnë në universitetet e ranguar më së larti në rangimin ndërkombëtar të universitetit pritës.
- Aplikanti/ja duhet të ketë llogari bankare aktive dhe në emër personal në Republikën e Kosovës.

Dokumentet e nevojshme:

- CV (Biografia).
- Kopjen e letërnjoftimit ose pasaportës së Republikës së Kosovës.
- Vërtetim nga universiteti pritës ku aplikuesi/ja vijon studimet e doktoratës.
- Nëse aplikohet, vërtetim nga institucioni vendor ku aplikuesi është i punësuar bashkë me sqarimin nëse aplikuesi/ja mbështetet edhe me pagesë ose jo për kryerjen e studimeve të doktoratës.
- Deklaratën nën betim të vërtetuar nga noteri (për kandidatët të cilët nuk janë të punësuar).
- Vërtetim se aplikuesi/ja nuk pranon mbështetje financiare nga universiteti pritës.
- Studentët që nuk janë në vitin e parë të studimeve të doktoratës, duhet të sjellin dëshmi lidhur me provimet e dhëna apo arritjen ekuivalente në programin e doktoratës (p.sh., projekte hulumtuese si pjesë e temës së doktoratës, botime shkencore, prezantimi i punës hulumtuese në konferenca shkencore relevante apo ngjashëm). Kjo vërtetohet me një dokument origjinal të nënshkruar dhe të vulosur nga autoritetet e universitetit.

Sqarime shtesë rreth aplikimit:

- Aplikimi duhet të dorëzohet në një zarf të mbyllur ku të jetë shkruar “Aplikimi për mbështetje financiare për doktoratë” në adresën rr. “Agim Ramadani” MASHTI zyra nr. 4.
- Aplikuesit të cilëve u mungon njëri nga dokumentet e kërkuara, diskualifikohen.
- Aplikimet pas afatit të specifikuar sipas këtij konkursi, nuk pranohen;
- Dokumentet të cilat nuk janë në njërën nga gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës ose në gjuhën angleze, duhen të jenë të përkthyer nga përkthyes të autorizuar.
- Nuk do të mbështeten aplikuesit që tashmë kanë dorëzuar temën e disertacionit dhe janë në pritje të mbrojtjes së saj.
- Nuk do të mbështeten aplikuesit të cilët kanë mbështetje financiare/bursë të plotë nga ndonjë skemë tjetër brenda apo jashtë vendit.
- Pas përmbylljes së procesit të përzgjedhjes, aplikuesit/et do të nënshkruajnë deklaratën e zotimit të përmbushjes së kushteve dhe obligimeve të kësaj mbështetjeje financiare.
- Studentët përfitues pritet të dorëzojnë në MASHTI kopjen e letërnjoftimit dhe konfirmimin bankar për llogarinë personale aktive.

Thirrja është e hapur nga data 19.09.2023 deri më 03.10.2023, ora 16:00.